



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	5 2 Nr. Prot: 2426 Prot. No: Datum: 04.10.2024 Date: Prishtine

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 04-10-2024
Nr. 572426

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037- në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesa nr. 2426 e datës 19.08.2024 e parashtruar nga BPrAL- kolegji “AAB” nxjerr:

V E N D I M

1. Bartësi Privat i Arsimit të Lartë / kolegji “AAB” kampusi kryesor, licencohet për periudhën 3 vjeçare (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027), me këto programe të studimit:

- Kontabilitet dhe Auditim MA, (vendimi nr. 1453/24 datë: 23.07.2024 të AKA-s)
- Programin BA Profesional (vendimi nr. 1514/24 datë: 05.08.2024 të AKA-s)
- Programin Multimedia BA Profesional (vendimi nr. 1514/24 datë: 05.08.2024 të AKA-s)
- Dizajn grafik dhe Art vizual BA, (vendimi nr. 1716/24 datë: 20.08.2024 të AKA-s)
- Dizajn grafik MA (vendimi nr. 1716/24 datë: 20.08.2024 të AKA-s).
- Banka Financa dhe Kontabilitet BSc (Vendim 1704/24 dt. 20.08.2024)
- Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve BA (Vendim 1704/24 dt. 20.08.2024)
- Shëndeti Mendor (Vendim 1704/24 dt. 20.08.2024)
- Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve MA (Vendim 1704/24 dt. 20.08.2024)
- Programi Lojërat Kompjuterike BA (Vendim 1767/24 datë 28.08.2024)
Biznes Digjital BA me specializimet : Inteligjenca Artificiale në Biznes dhe Menaxhimi i Rrjeteve Sociale (Vendim 1767/24 datë 28.08.2024)
- * Administratë Publike BA me specializimet : Administratë Publike; Shkenca Politike dhe Diplomaci (vendimi 1767/24 datë 28.08.2024).

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 2426 e datës 19.08.2024, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë zgjat tri vite akademike të programeve të studimit bazuar në vendimet e Agjencionit të Kosovës për Akreditim, pra për periudhën kohore nga data 1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027 si në dispozitiv të pika 1.

Komisioni për licencim dhe rilicencim në MASHTI, duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin e kompletuar për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.


Kryetar i Komisionit

Burim Gashi